



UNIVERSITETI I SHKODRËS  
"LUIGJ GURAKUQI"



UNIVERSITETI  
MARIN BARLETI

Nr Protokolli 1051

Nr Protokolli 1617.

## MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM INSTITUCIONAL

### 1. Palët e marrëveshjes

Sot më datë 27 / 03 / 2017, në Shkodër, nënshkruhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet Universitetit të Shkodrës Luigj Gurakuqi, përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Adem BEKTESHI, dhe SHLUJ "Universiteti Marin Barleti, përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Marenglen SPIRO me qëllim mbështetjen reciproke, si dhe nxitjen e shkëmbimeve të eksperiencave sipas objektit të veprimtarisë së tyre, pa çënuar misionet respektive. Palët në këtë marrëveshje, bien dakord të bashkëpunojnë për realizimin e veprimtarive të poshtëshënuara në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion.

**2. Parimet e bashkëpunimit:** Institucionet nënshkruese të kësaj marrëveshje konfirmojnë nevojën e përpjekjeve në drejtim të konsolidimit të vlerave kulturore, shkencore dhe akademike në vend, e cila ndikon pozitivisht në drejtim të forcimit të klimës së shtetit të së drejtës dhe impenjohen:

1. Të punojnë së bashku në frymën e barazisë, reciprocitetit, transparencës, lehtësimit të pjesëmarrjes dhe zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme në drejtimin e studimeve shkencore;
2. Të promovojnë iniciativat shkencore dhe të shkëmbimit kulturor me qëllim rritjen e kapaciteteve njerëzore në drejtimin e studimeve shkencore;
3. Të nxisin promovimin e standardeve më të larta në cilësinë e kërkimit si edhe të integritetit etik në punën kërkimore.

### 3. Drejtimet e realizimit të bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve do të përfshijë dy drejtime.

#### A) Bashkëpunimi i përgjithshëm institucional nëpërmjet:

- Përcaktimit të fushave kërkimore me qëllim integrimin midis strukturave për aktivitetin didaktiko-teoriko-praktik, të zhvilluar në mbështetje të kurseve universitare dhe pasuniversitare;
- Shkëmbimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore të institucioneve në aktivitete didaktike, projekte të kërkimit shkencor me interes të përbashkët si: konferenca, seminare, bashkëbisedime me studentë të tjerë;
- Mbështetjes së kërkimit shkencor të orientuar drejt praktikës duke u mbështetur nga metodologji të bazuara në vëzhgime të thelluara dhe të situatave komplekse, rastë studimore, anketime ose racionalizëm të përvojës së akumuluar menaxheriale dhe konsultative të institucioneve;





UNIVERSITETI I SHKODRËS  
"LUIGJ GURAKUQI"



UNIVERSITETI  
MARIN BARLETI

- Organizimit të përbashkët të kurseve specifike, trajnimeve, leksioneve të hapura apo seminareve në lidhje me tematika që kanë interes studimor ose praktik.
- Shkëmbimit të materialeve dhe rezultateve të punës studimore dhe shkencore që realizohet në të dy institucionet;
- Krijimit të lehtësive për kryerjen e praktikave mësimore të studentëve të "Universitetit të Shkodrës" pranë institucionit përkatës dhe institucioneve në varësi;

**B) Bashkëpunimi në fushën e studimeve do të konkretizohet nëpërmjet:**

- Mbështetjes dhe bashkëpunimit reciprok në organizimin e projektit kërkimor shkencor të Universitetit të Shkodrës si dhe në organizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në fusha të ndryshme.
- Gatishmërisë së palëve nënshkruese për të mirëpritur studentët e regjistruar në programet studimore për të konsultuar materialet e ndryshme të institucionit dhe institucioneve në varësi, me qëllim kërkimin shkencor dhe praktikën profesionale sipas rregullave të këtij të fundit.
- Mbështetjes dhe bashkë-udhëheqjes të studentëve gjatë realizimit të projektit shkencor dhe praktikës profesionale.
- Krijimit të lehtësirave të nevojshme nga ana e institucionit për realizimin e studimeve universitare të studentëve të Universitetit të Shkodrës..

**Ndryshimi/Revokimi i marrëveshjes**

Çdo parashikim i kësaj marrëveshje mund të ndryshohet apo të revokohet në çdo kohë, pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet dy institucioneve.

**Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë, pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e institucioneve përkatëse.

Universiteti i Shkodrës  
"Luigj Gurakuqi"

SHLUIJ"Universiteti Marin  
Barleti"

Rektori  
Prof.dr Adem BEKTESHI

Rektori  
Prof. Dr. Marenglen SPIRO

Shkodër më 27.1.03.../2017

Tiranë më 27.03/2017

